

Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Fjalimi i Xhumasë i  
Kalifit të V-të të Xhematit Islamik Ahmedia  
Hazret Mirza Masroor Ahmed-it  
mbajtur në Baitul Futuh të Londrës

## më **3 shkurt '06**

Në fjalimin tim të fundit kam folur për fatkeqësitë natyrore: tërmetet, stuhitë, vërshimet etj. Pas tërmetit që ndodhi në veri të Pakistanit para pak kohe, njerëzit filluan t'u shtrojnë shumë pyetje ulemave (dijetarëve të fesë). Dhe të gjithë ulematë pohuan se këto fatkeqësi janë për shkak të mëkateve dhe largimit nga rruga e drejtë dhe janë dënim prej Allahut. Ata gjithashtu thanë se këto fatkeqësi nuk kanë ndonjë lidhje me ardhjen e Mesihut e të Imam Mehdiut për shkak se ardhja e tyre do të ndodhë pak para Ditës së Kiametit. Njëri prej këtyre dijetarëve tha se kanë mbetur edhe 700 vjet deri në ardhjen e tyre.

Ata mendojnë se askush nuk do të bëjë hulumtime lidhur me këtë çështje. Më parë thoshin se edhe pse Mesihu duhej të paraqitet në shekullin e 14<sup>të</sup>, ai ende nuk është paraqitur. Shekulli i 14<sup>të</sup> nuk ka përfunduar ende dhe ka ende kohë deri në përfundimin e tij. Pastaj edhe shekulli i 14<sup>të</sup> kaloi dhe disa hoxhallarë injorantë, (në fakt të gjithë ata që nuk e kanë pranuar Mesihun e Premtuar janë injorantë) disa prej tyre pohonin se shekulli i 14<sup>të</sup> është zgjatur dhe nuk do të përfundojë deri në ardhjen e tij. Të tjerët këto pikëpamje i konsideruan marrëzira. Disa që konsideroheshin më të ditur morën qëndrim se ardhja e Mesihut dhe Imam Mehdiut është njëra prej shenjave të Ditës së Gjykimit, prandaj kjo kohë ende nuk ka ardhur. Disa dijetarë arabë, në kundërshtim me besimin e tyre të mëhershëm, erdhën në përfundim se Hazret Isa<sup>as</sup> ka vdekur dhe në të njëjtën kohë gjithashtu erdhën në përfundim se të gjitha hadithet që bëjnë fjalë për ardhjen e dytë të Isait<sup>as</sup> dhe të Imam Mehdiut janë të pavërteta dhe se në fakt askush nuk do të vijë më dhe se ne hoxhallarët jemi të mjaftueshëm për reformimin e fesë.

Me gjithë mungesën e argumenteve, ata insistonin në qëndrimet e tyre dhe lëshonin fatve (dekrete ose deklarata) të njëpasnjëshme kundër Xhematit Ahmedia. Në deklaratat e tyre na vishnin të tilla absurditete që nuk kanë as lidhjen më të largët me mësimet tona. Qëllimi i vetëm i këtyre deklaratave ishte që të krijojnë urrejtje kundër Ahmedianëve. Ne vetëm kaq themi duke e cituar Mesihun e Premtuar: 'LanatuLlahi 'alal kadhibiina wal faasikiin' -

'Mallkimi qoftë mbi gënjeshtarët dhe mizorët', dhe ia lëmë çështjen e tyre Allahut.

Ditëve të fundit edhe dy dekrete të ngjashme janë lansuar. Por, kjo nuk do ta zbehë simpatinë tonë që kemi për myslimanët në përgjithësi dhe nuk do të na zbrapsë në misionin tonë të përhapjes së mesazhit. Duke e pasur parasysh këtë, unë do të flas sot për ardhjen e Mesihut të Premtuar<sup>ass</sup> dhe për kohën e paraqitjes së tij.

Siç thashë më parë, në të kaluarën të gjithë ulematë ishin të bashkuar në opinionin e tyre se ai do të vinte në shekullin e 14<sup>të</sup> dhe të gjithë njerëzit e shenjtë të umetit dhe ulematë pohonin se kjo ishte koha e paraqitjes së Imam Mehdiut dhe të Mesihut të Premtuar. Dijetarët bashkëkohës të Mesihut të Premtuar<sup>ass</sup> dhe disa që jetuan pak para kohës së tij, duke e parë gjendjen e mjerueshme të myslimanëve ata ishin të sigurt se së shpejti Mehdiu do të paraqitej. Ata, me dhimbje në shpirt i luteshin Allahut që sa më shpejt ta dërgonte atë që ta shpëtonte anijen e Islamit që po fundosej.

Unë do të lexoj disa citate të dijetarëve eminentë të kohës së Mesihut të Premtuar<sup>ass</sup> dhe të kohës para tij. I pari është Hazret Niametullah Vali që ishte një Aulija i vërtetë. Ai në një poemë në gjuhën persiane shkruan se pasi të kenë kaluar 1200 vjet, shenjat e paralajmëruara do të duken dhe Mehdiu e Mesihu do të paraqiten.

Pastaj, Hazret Shah Valiullah Muhadith Delhevi i cili vdiq më 1136 të Hixhrit, thotë se Allahu më ka njoftuar se Dita e Gjykimit është afër dhe Mehdiu veç sa s'është paraqitur. Ai thotë më tutje se data e paraqitjes së Mehdiut do të jetë 'çiragh din'. Vlera numerike e këtyre shkronjave është 1286.

Pastaj Navab Sadik Hasan Khan Sahibi, i cili nuk e kishte pranuar Mesihun e Premtuar, duke e cituar Imam Xhafer Sadikun thoshte se Imam Mehdiu do të paraqitej 1200 vjet pas Hixhrit. Ai thoshte se sipas llogaritjeve të tij, Mesihu duhet të paraqitet në shekullin e 13<sup>të</sup> të Hixhrit. Ai vazhdonte duke thënë se kjo kohë tashmë ka kaluar dhe Mehdiu ende nuk është paraqitur dhe ka gjashtë muaj që jemi futur në shekullin e 14<sup>të</sup>. Allahu pastë mëshirë. Ai megjithëkëtë nuk e pranoi Mesihun e Premtuar<sup>ass</sup>. Navab Sadik Hasan Khan thoshte se asnjë pohues nuk mund ta kalojë shekullin e 14<sup>të</sup> të Hixhrit, sepse të gjitha profecitë, shenjat dhe vizionet e caktojnë shekullin e 14<sup>të</sup> për paraqitjen e Mesihut dhe të Imam Mehdiut. Mesihu i Premtuar<sup>ass</sup> thoshte gjithashtu se edhe hëna vjen duke e shtuar dritën e saj deri në natën e 14<sup>të</sup>.

Pastaj është Molana Sajid Abdul Hasan Ali Nakvi, i cili gjithashtu nuk kishte besuar në Mesihun e Premtuar<sup>ass</sup>, madje ishte njëri prej kundërshtarëve të tij, thoshte se gjendja në të cilën ndodhen myslimanët është e mjerueshme. Ata e

kanë humbur shpresën që do të mund të reformohen përmes mjeteve normale dhe janë duke e pritur dikë që do të caktohet prej Allahut. Disa mendojnë se në fund të shekullit 13<sup>të</sup> Mesihu dhe Mehdiu duhet patjetër të paraqiten. Kjo vërteton - thotë Kalifi - se koha e Mesihut të Premtuar kishte ardhur, por ata nuk ishin gati që ta pranonin pohuesin. Pastaj thotë, (vazhdon citati) se bota e Islamit është duke vuajtur prej sëmundjeve të shumta morale dhe shpirtërore dhe gjithandej ndjehet një erë dëshpërimi. Disa i adhurojnë varret e Aulijave duke bërë shirk dhe të tjerët janë zhytur në besëtytni. Një gjendje e tillë kërkon një reformator, i cili do ta pastronte Islamit nga këto botëkuptime injorante dhe me guxim do të thërriste drejt Unikatësisë së Allahut.

E gjithë kjo ishte duke ndodhur dhe ata e pranonin këtë fakt, madje edhe sot e pranojnë dhe megjithëkëtë thonë se ne ende nuk kemi nevojë për ndonjë reformator. Sipas tyre, edhe pse feja e zgjedhur e Allahut gjendet në këtë gjendje të mjerueshme, Allahu nuk bëhet merak se çka po ndodh me fenë e tij dhe se Ai e ka harruar premtimin e Tij për t'i dërguar Mehdiun dhe Mesihun që ia kishte premtuar Umetit të Tij.

Hazret Ebu Katada transmeton se e kishte dëgjuar të Dërguarin e Allahut<sup>sas</sup> duke thënë se shenjat e Ditës së Gjykimit do të paraqiten 200 vjet pas 1000 vjetëve të hixhrit. Hazret Kadri duke e shpjeguar këtë thotë se, kjo do të thotë se pas 1200 vjetëve të gjitha shenjat do të paraqiten dhe ajo kohë do të jetë koha e ardhjes së Mesihut të Premtuar dhe Imam Mehdiut. Të gjitha këto fakte vërtetojnë se kjo ishte koha e paraqitjes së tyre. Megjithëkëtë, shumica e ulemave të ditëve tona pohojnë se ende jemi larg asaj kohe.

Të gjitha citatat e dijetarëve dhe të njerëzve të shenjtë që i lexova më lart vërtetojnë se koha e paraqitjes së Mehdiut dhe Mesihut ishte pas shekullit të 12<sup>të</sup> të hixhrit. Ata nuk thanë se ai do të paraqitej në shekullin e 9<sup>të</sup> apo në të 20<sup>in</sup> apo në ndonjë kohë tjetër, por gjithmonë e kanë përmendur shekullin e 12<sup>të</sup>, që dëshmon qartë se rreth kësaj kohe Mesihu dhe Imam Mehdiu do të paraqiten. Edhe Hazret Shah Valiullah Muhadith Delhevi i cili ishte muxhadid (reformator) i shekullit të 12<sup>të</sup>, thoshte se koha e paraqitjes së Imam Mehdiut ishte 1268. Kjo pra përafërsisht ishte koha në të cilën pritej paraqitja e tij.

Mesihu i Premtuar<sup>ass</sup> e ka paraqitur si argument Ajetin e Kur'anit '**Va akharina min hum lammaa jal hakubi him**', duke thënë se vlera numerike e këtyre shkronjave është 1275. Pra, ai që do t'i lidhte popujt e ditëve të vona me ata të kohëve të hershme, ai duhej të paraqitej në këtë kohë. Mesihu i Premtuar thotë se ky ishte viti në të cilin unë e kam arritur pjekurinë time shpirtërore dhe Allahu po më përgatiste për këtë mision.

Pra, të gjitha këto gjëra nuk janë të rastësishme. Nëse këta hoxhallarë kanë pak logjikë, duhet të ndalen dhe të mendojnë se këto janë lajme të njerëzve të shenjtë të Umetit. Ka pastaj edhe shumë hadithe të Profetit të Shenjtë<sup>sas</sup> dhe

indikacione në Kuranin e Shenjtë që flasin për kohën e ardhjes së Mesihut. Ata duhet të mendojnë për këto gjëra dhe nuk duhet t'i devijojnë njerëzit e thjeshtë, duke u thënë se të gjitha këto nuk kanë asnjë lidhje me paraqitjen e Mesihut, madje as këto fatkeqësi natyrore kaq të shpeshta.

Kohën e paraqitjes së tij, Mesihu i Premtuar<sup>asa</sup> e ka vërtetuar nga vetë Kur'ani i Shenjtë. Por, para kësaj lejomëni ta lexoj një hadith i cili tregon se nuk mund të presësh shumë nga ulematë e ditëve tona. Hadhrat Abdullah bin Amer bin al-As<sup>ra</sup> transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut<sup>sas</sup> duke thënë: "Allahu nuk do ta marrë dijen menjëherë prej tyre, por ajo do të zhduket gradualisht dhe kur nuk do të ketë më dijetarë, njerëzit do t'i marrin analfabetët si dijetarë dhe do t'u drejtohen atyre për çështjet e fesë dhe vetë do të devijohen dhe do t'i devijojnë të tjerët".

Ky hadith natyrisht që flet për të ashtuquajturit dijetarë të fesë të kohës sonë të cilët i devijojnë njerëzit dhe mundohen t'i mbajnë larg njohjes së Imamit të kohës dhe larg kërkimeve, nga frika se mos do ta zbulojnë të vërtetën. Ky hadith e bën të qartë gjendjen e tyre. Kjo gjendje e tyre është përmendur edhe në Kuranin e Shenjtë. Pra, duke qenë dëshmitarë të këtij realiteti, anëtarët e Xhematit tonë nuk duhet të rrinë duarkryq, por duhet t'i informojnë njerëzit dhe t'u thonë se nëse nuk e pranojnë Fjalën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, fundi i tyre do të jetë hidhërimi i Allahut.

O myslimanë! Nëse e dëshironi kënaqësinë e Allahut dhe dëshironi ta shpëtoni fenë tuaj, ta keni këtë botë dhe botën tjetër, atëherë duhet të ndaleni dhe t'ua vini veshin këtyre argumenteve dhe të shikoni se a mos rastësisht kjo kohë është koha e Imamit të Premtuar?! Të gjitha këto fatkeqësi natyrore që po godasin, a nuk janë si rezultat i zemërngurtësisë së myslimanëve dhe të gjendjes së tyre të mjerueshme në botë.

Ne e pamë se ulematë e ditëve tona dhe ata të kohës së Mesihut të Premtuar<sup>ass</sup> e kanë pranuar se gjendja prezent e myslimanëve është e mjerueshme. Tani, cili ishte premtimi i Allahut për atë kohë kur myslimanët do të përjetonin një degradim të këtillë? Allahu ka premtuar se kur besimi do të zhdukej plotësisht nga faqja e dheut dhe do të ngjitej në yjet e largëta, një njeri me prejardhje persiane do ta sillte atë përsëri në tokë. Kur zbriti ajeti, '**va aaharina min hum lammaa jal hakubi him**' - 'dhe të tjerët që ende nuk u janë bashkuar', dikush prej të pranishmëve e pyeti Profetin e Allahut, se kush ishin këta njerëz të kohëve të vona? I Dërguari i Allahut e vuri dorën e tij mbi supin e Selman Farsit dhe tha se kur feja do të zhdukej plotësisht nga toka dhe do të ngjitej në yjet e largëta në qiell, dikush prej popullit të tij do ta zbresë atë përsëri në tokë.

Të gjithë e pranojnë se feja është zhdukur nga faqja e dheut dhe megjithëkëtë thonë se ende nuk ka ardhur koha e ardhjes së Imamit të Premtuar. Por, Allahu dhe i Dërguari i Tij, nuk e lan me kaq. Ata përmendën edhe shenja të tjera nga të cilat do ta njohim atë kohë. Kjo gjithashtu do të jetë edhe koha e Dexhallit. Mesihu i Premtuar<sup>ass</sup> thotë se ka dy lloj argumentesh për të ardhur në përfundim se kjo është ajo kohë në të cilën Mesihu duhet të paraqitet. Së pari janë ajetet e Kuranit dhe së dyti hadithet e Profetit të Shenjtë të cilat tregojnë që Dita e Kiametit është afër. Kjo nuk do të thotë se kanë mbetur vetëm disa orë deri në ditën e Kiametit, porse koha është duke ecur në atë drejtim. Kurani i Shenjtë thotë: **'Kur devetë do të braktisen'**. *'Isharu'* është deveja pëlle e cila ishte shumë e çmueshme ndër arabët. Kjo flet për shpikjen e mjeteve të tjera të transportit në kohët e vona të cilat do ta zëvendësojnë devenë.

Një ajet tjetër thotë: **'Va idha nafusu zuvixhat'** - që do të thotë kur njerëzit do të komunikojnë me njëri tjetrin. Kjo flet për mënyrat e reja të komunikimit dhe të transportit që do t'i afrojnë njerëzit me njëri tjetrin. Tani njerëzit jo vetëm që po flasin me njëri tjetrin nga distanca të largëta, por edhe po arrijnë ta shohin njëri-tjetrin. Një komb do të takohet me kombin tjetër dhe do të zhvillohet tregtia me vende të largëta dhe do të ketë më shumë marrëdhënie miqësore në mes popujve. Kjo profeci po plotësohet para syve tanë në këtë kohë. Pastaj ai citon një ajet tjetër të Kur'anit: **'Va idha shamsu kuvirat'** kur dielli do të mbulohet, që do të thotë se do të mbretërojë një injorancë e plotë shpirtërore në botë.

Mesihu i Premtuar<sup>ass</sup> thotë më tutje se Allahu në kohën tonë i ka krijuar të gjitha mjetet e predikimit, shtypshkronjat, letrën, postën dhe bota është bërë si një qytet i vetëm. Botimi i gazetave dhe publikimeve të tjera është dukuri tipike e kohës sonë të cilën nuk e hasim në ndonjë kohë tjetër në të kaluarën. Unë po flisja për **'idha shamsu kuvirat'**. Mesihu i Premtuar<sup>ass</sup> thoshte se do të kishte një errësirë të plotë dhe ligësia do të përhapej kudo. Pastaj thotë **'va idha naxhumu kadirat'** - kur yjet do ta humbin shkëlqimin që do të thotë se sinjeriteti i ulemave do të zhduket. Sipas kësaj profecie të vjetër dijetarët e fesë nuk mund ta gjejnë dritën e sinjeritetit përderisa të mos e njohin Imamin e Kohës. Ngjashëm ata para tyre që ishin duke pritur, e lanë këtë botë dhe edhe këta do të vdesin, por myslimanët duhet të kenë kujdes që të mos e humbin këtë botë dhe botën tjetër dhe duhet ta dinë se nuk mund të arsyetohen para Zotit duke thënë se ne i kemi pasuar hoxhallarët tanë. Ajetin që e recitova në fillim të fjalimit thotë: "Asnjë shpirt nuk do ta bartë barrën e tjetrit". Rreth kësaj duhet të mendoni.

Ka pastaj edhe një profeci tjetër të Kuranit të shenjtë: **'Va idhal vuhushu hushirat'** - 'Kur kombet e pa civilizuara do të civilizohen'. Të gjitha këto profeci po plotësohen. **'Va idha suhufu lushirat'** do të thotë se do të ketë

shumë publikime dhe njerëzit fare lehtë do të kenë akses (hyrje) në libra dhe publikime të ndryshme. **'Va idhal biharu sugjirat'** - 'Kur oqeanet do të bashkohen'. Tani përmes kanaleve, detet dhe oqeanet janë bashkuar me njëri tjetrin. Të gjitha këto shenja tregojnë se këto janë kohët e vona dhe kjo është koha e Dexhallit, e cila është njëkohësisht edhe koha e paraqitjes së Mesihut të Premtuar. Pra, kur të gjitha këto shenja janë duke u përmbushur para syve të tyre, pse ata ende po presin për ardhjen e Mesihut. Pse po mundohen ta lidhin ardhjen e tij me Ditën e Gjykimit dhe insistojnë në të.

Është edhe një hadith tjetër i cili flet rreth ardhjes së Imamit të Premtuar, të cilin sa herë që Ahmedianët ua citojnë kundërshtarëve, ata nuk kanë nga t'ia mbajnë. Ky është hadithi që flet për eklipsin e diellit dhe të hënës. Mesihu i Premtuar<sup>ass</sup> e ka paraqitur këtë argument si shenjë të vërtetësisë së tij. Profeti i Shenjtë<sup>sas</sup> ka thënë, se kjo shenjë kurrë nuk do të paraqitet përveç se për Imam Mehdiun. Pra, nëse insistoni se Mirza Ghulam Ahmed Kadijani nuk është Mesihu i Premtuar, atëherë, pasi që eklipset kanë ndodhur dhe Mesihu duhet të kishte qenë patjetër prezent, ju duhet ta gjeni një dikë tjetër në vend të tij, sepse eklipset nuk duhet të kenë ndodhur kot. Por, edhe pas kësaj shenje të madhe ata përsëri insistojnë se koha e paraqitjes së Imam Mehdiut ende nuk ka ardhur. Hadithi në fjalë thotë: **'Janë dy shenja për Mehdiun tonë, të cilat kurrë nuk janë paraqitur për vërtetësinë e askujt, prej krijimit të qiejve dhe të tokës. Hëna do të zihet në natën e parë të eklipseve të saj dhe dielli do të zihet në ditën e mesme të eklipseve të tij.'**

Mesihu i Premtuar<sup>asa</sup> gjithashtu ka thënë se Mesihu duhet të paraqitej në kohën e Jaxhuxh dhe Maxhuxhit. Rrënja e këtyre dy fjalëve do të thotë **'zjarr'**. Kjo do të thotë se këta janë ata dy popuj që do ta vënë zjarrin në shërbim të tyre. Avionët, trenat dhe makinat e tyre do të lëvizin me ndihmën e zjarrit dhe ata do të jenë ekspertë të përdorimit të zjarrit për nevojat e tyre. Këta janë popujt e Perëndimit që të parët i kanë shpikur makinat e tilla.

Në librat e vjetër të profetëve të Izraelit, Evropa është quajtur Jaxhuxh dhe Maxhuxh dhe madje edhe emri Moskë është përmendur që ka qenë qendër e Rusisë në atë kohë. Kjo pra është koha e Jaxhuxhit dhe Maxhuxhit. Prandaj, dijetarët myslimanë duke nxjerrë dritë nga Kurani dhe hadithet kanë ardhur në përfundim që Mesihu dhe Mehdiu do të paraqitet në atë kohë. Gjendja e përgjithshme në botë, si dhe gjendja e mjerueshme e myslimanëve, tregojnë qartë se kjo duhet të jetë ajo kohë. Të gjitha shenjat e Kuranit që i përmenda më lart, i referohen kohës sonë. Pra, duke i parë të gjitha këto fakte dhe argumente, ata duhet ta kuptojnë se kjo është koha e Mesihut të Premtuar dhe Imam Mehdiut.

Eklipsi i hënës dhe i diellit është një shenjë e madhe për të cilën ka folur edhe Imam Bakiri dhe ka thënë se në kohën e Mesihut të Premtuar hëna dhe dielli do të eklipsohen. Dhe përsëri të thuhet se ende nuk është koha e Mesihut dhe

e Mehdiut, kjo do të thotë të ndjellësh hidhërimin e Allahut. Ata vetë e pranojnë se këto katastrofa natyrore po ndodhin për shkak të gabimeve tona dhe jetës sonë mëkatore. Në ajetin që e recitova më lart, Allahu thotë qartë se ne nuk e dënojmë një popull deri sa të mos i dërgojmë ndonjë profet që t'ua tregojë rrugën e drejtë. Prandaj duke pohuar se këto janë dënime prej Allahut, ata duhet të mendojnë më thellë për fjalët e këtij ajeti, në vend që të pohojnë se kjo nuk është koha e Mesihut dhe nuk ka ndonjë lidhje me të, ose se ka edhe 726, 728 apo 200 vjet deri në ardhjen e tij, apo të gjitha hadithet janë të pavërteta.

Në vend që ta refuzojnë këtë vërejtje të Allahut, është më mirë që të kërkojnë udhëzim prej Tij dhe të futen nën mbrojtjen e Tij. Allahu u dhëntë urtësi të gjithë myslimanëve që ta kuptojnë këtë vërejtje të fortë të Allahut. Të ashtuquajturit ulema - dijetarë të fesë janë lëshuar në kënaqësitë e botës dhe po bëjnë jetë të shthurur dhe po u japin jomuslimanëve shans që ta sulmojnë Islamin, siç kanë bërë së voni me karikaturat e Profetit të Shenjtë<sup>sas</sup>. Janë vetë myslimanët me veprat e tyre që po ju japin shans armiqve të Islamit që të lansojnë sulme të tilla dhe pastaj dalin nëpër rrugë e bëjnë zhurmë. Në Danimarkë, redaktori i gazetës ka kërkuar falje. Në fillim insistonte se ajo që ka bërë ka qenë e drejtë, por kur delegacioni ynë i takoi dhe ua shpjegoi gjërat, ata kërkuar falje dhe në prezencën e tyre e pranuan se kishin bërë gabim.

Kjo është duke ndodhur edhe në vende të tjera dhe delegacionet tona duhet të shkojnë e të takohen me ta dhe t'i informojnë drejt. Shumë probleme janë duke ndodhur për shkak të veprave të vetë myslimanëve që po u japin shkas kundërshtarëve të Islamit të lansojnë sulme të tilla.

Në Suren Takvir ku ka profeci për këtë kohë, ka gjithashtu edhe profeci për fitoren përfundimtare dhe lulëzimin e Islamit që është i lidhur me Mesihun e Premtuar<sup>ass</sup>. Dhe lajmi është dhënë. Prandaj askush nuk duhet të jetojë me iluzionin që pa e besuar Mesihun e Premtuar, Islami do ta arrijë shkëlqimin dhe triumfin e tij. Besimi i tyre është se detyra e Mesihut do të jetë t'i vrasë derrat. Mesihu i Premtuar<sup>ass</sup> ka thënë se për këtë punë mjaftojnë të krishterët të cilët i vrasin dhe i hanë derrat. Ku është nevoja që Mesihut t'i besohet kjo 'detyrë e nderuar'. Allahu u dhëntë urtësi këtyre 'dijetarëve' të Islamit dhe umetit të myslimanëve që ta njohin të vërtetën. Allahu i haptë mendjet e tyre dhe i udhëzoftë. Detyra jonë është që të lutemi për ta dhe t'ua tregojmë rrugën e drejtë dhe këtë do të vazhdojmë ta bëjmë. Insha'allah!

This is an Albanian translation of Hazoo'r Khutba of 3 February '06. The topic of this Khutba is '**The signs of the coming of the Messiah & Mehdi**'. This translation has been prepared by the members of Kosovo Jama'at.